Kanton St.Gallen
Amt für Wirtschaft und Arbeit

# Çfarë duhet të dini si kliente e RAV-it dhe klient i RAV-it.



# Parafjalë

E nderuara kliente
I nderuar klient

Humbja e vendit të punës mund të ju prek sot të gjithëve dhe papunësia e ndërlidhur me këtë është për ju dhe mjedisin tuaj (RAV) shpesh e veshtirë dhe e dhimbshme. Është dëshira jonë e përbashkët që ju të gjeni sa me shpejt një vend pune.

Qendrat regjionale për ndërmjetësim të punësimit të regjionit tuaj ju ndihmojnë në kërkimin e punës dhe janë në dispozicionin tuaj sa i përket pyetjeve në lidhje me sigurimin e të papunëve. Këshilltaret personale dhe këshilltarët personal me pervojë vendosin së bashku me ju që të gjeni sa më shpejt kyçjen në botën e punës. Si plotësim i këshillimit personal keni në përzgjedhje oferta të ndryshme të kualifikimit dhe punësimit për një kërkim të suksesshëm të punës.

E ardhmja e juaj profesionale është në duart tuaj. Dhe në këtë kërkohet angazhimi, besimi dhe bashkëpunimi konstruktiv i juaj. Duke e informuar njëri-tjetrin në mënyrë të hapur dhe detyruese, ne krijojmë një bazë të mirë të besimit për të bashkëpunuar në mënyrë të vendosur dhe të suksesshme.

Broshura që ndodhet para jush ju paraqet një përmbledhje mbi të drejtat dhe obligimet e juaja si një person punëkërkues. Ju lutemi, që me anë të kësaj broshure dhe të E-Learning Tool (www.awa.sg.ch) të përgatiteni për takimin e juaj të parë këshillues. Këshilltarja e juaj personale ose këshilltari i juaj personal ju përgjigjet me kenaqësi pyetjeve të hapura.

Kasa e të papunëve që keni përzgjedhur ju, e kontrollon kërkesën tuaj për dëmshpërblim, e llogarit dëmshpërblimin e të papunëve (ALE) dhe e paguan dëmshpërblimin tuaj. Në rast së keni pyetje në lidhje me këto pika atëherë drejtohuni direkt kases suaj të të papunëve.

Ne shpresojmë për një bashkëpunim të mirë dhe të suksesshëm dhe ju dëshirojmë sukses gjatë kërkimit të punës.

Karin Jung
Udhëheqësja e Entit
për Ekonomi dhe Punë

Walter Abderhalden
Udhëheqës kryesor i departamentit
të sigurimit të të papunëve

**Bazat ligjore**
Bazat ligjore i gjeni në ligjin për sigurimin e të papunëve (AVIG) dhe në rregulloren për sigurimin e të papunëve

# Përmbajtja

Shfrytëzoni periudhën e shkarkimit Faqe 5
Udhëzues për të siguruarit
E-Learning
Kërkimi i punës para regjistrimit
Ligjshmëria e shkarkimit

Mbarimi i marrëdhënieve të punës Faqe 7
Marrëdhënia e punës për kohë të caktuar
Marrëdhënia e punës për kohë të pacaktuar
Periudha e shkarkimit në marrëdhëniet e punës sipas së drejtës private
Periudha provuese në marrëdhëniet e punës sipas së drejtës private
Efektshmëria e shkarkimit

Këshilla për kërkimin tuaj të punës Faqe 8
Veprimi sistematik
Vendet e lira punësimi
Të aplikosh në mënyrë kompetente
Zyra e aplikimit

Të drejtat e juaja si kliente e RAV-it dhe klient i RAV-it Faqe 9
E drejta për dëmshpërblim të papunësisë
Lartësia e dëmshpërblimit të papunësisë
Zgjatja e pagesës së dëmshpërblimit të papunësisë
Takimet këshilluese
Masat e tregut të punës
Pushimet gjatë papunësisë
Mbrojtja e të dhënave
Pagesat gjatë kërkimit të punës jashtë shtetit

Obligimet e juaja si kliente e RAV-it dhe klient i RAV-it Faqe 12
Dispozicioni
Obligimi i informimit dhe lajmërimit
Kërkimi i punës dhe obligimi, të pranosh një punë të arsyeshme
Dëshmia e përpjekjeve personale për punësim
Formulari «Dëshmia e përpjekjeve personale për punësim»

Obligimi i zvogëlimit të dëmit Faqe 14
Obligimi i zvogëlimit të dëmit
Arsyet për ndërprerje e mundshëm të shërbimeve financiare
Formulari «Të dhënat e personit të siguruar»

Sigurimet e juaja gjatë papunësisë Faqe 16
AHV/IV/EO
Sigurimi pensional
Aksidenti
Sëmundja
Lehonia

# Regjistrimi

## Shfytëzoni periudhen e shkarkimit

Regjistrohuni sa më herët **personalisht** në njerën prej gjashtë zyrave të RAV-it në kantonin e St.Galles, kur shkarkimi veq iu është shqiptue ose kur llogarisni se do të humbasni vendin tuaj të punës, por më së voni në ditën e parë të papunësisë tuaj.

Takimi i juaj i parë këshillues mbahet pastaj në zyrën e RAV-it të caktuar për vendbanimin tuaj.




RAV St.Gallen
Geltenwilenstrasse 16/18
9001 St.Gallen
info.ravstg@sg.ch
+41 58 229 25 35

RAV Heerbrugg
Berneckerstrasse 12
9435 Heerbrugg
info.ravher@sg.ch
+41 58 229 97 77

RAV Sargans
Langgrabenstrasse 24
7320 Sargans
info.ravsar@sg.ch
+41 58 229 82 68

AWA St.Gallen
Unterstrasse 22
9001 St.Gallen
info.vdawa@sg.ch
+41 58 229 35 47

RAV Rapperswil-Jona
Neue Jonastrasse 59
8640 Rapperswil
info.ravrap@sg.ch
+41 58 229 76 56

RAV Wil
Säntisstrasse 2
9500 Wil
info.ravwil@sg.ch
+41 58 229 93 93

RAV Wattwil
Bahnhofstrasse 34
9630 Wattwil
info.ravwat@sg.ch
+41 58 229 91 71

Kantonale ALK St.Gallen
Geltenwilenstrasse 16/18
9001 St.Gallen
arbeitslosenkasse@sg.ch
+41 58 229 47 11

**Shpjegim i shkurt**

**«Regjistrimi në RAV»**
Një regjistrim retroaktiv përjashtohet parimisht. Regjistrimi duhet bërë personalisht.

**Regjistrimi në RAV**
www.rav.sg.ch

**Orari i punës**
Nga e hëna deri të premten
08.00 – 11.30
14.00 – 17.00

## Udhëzues për të siguruarit

Në broshurën e Sekretarariatit Shtetëror për Ekonomi (SECO) «Një udhëzues për të siguruarit» ju do të keni një përmbledhje mbi rrjedhat, të drejtat, obligimet dhe burimet e informimit në rast të (kanosjes së) papunësisë.

Për temën:
Broshura gjendet tek RAV-i. Ju mund ta gjeni poashtu në mënyrë elektronike në www.arbeit.swiss

## E-Learning

Njohuritë për RAV-in online: E-Learning
http://www.awa.sg.ch/home/e-learning.html

## Kërkimi i punës para regjistrimit

Filloni gjatë periudhës së shkarkimit intensivisht me kërkimin e punës.
Dokumentoni përpjekjet për punësim dhe ruani çdoherë aplikacionet dhe shënimet e punëdhënësve.

## Ligjshmëria e shkarkimit

Në rast së nuk jeni të sigurt, që shkarkimi i vendit tuaj punës ka qenë i ligjshëm, atëherë drejtohuni kasës të të papunëve që keni përzgjedh.

# Mbarimi i marrëdhënieve të punës

## Marrëdhënia e punës për kohë të caktuar

Një marrëdhënie e punës për kohë të caktuar mbaron normalisht në afatin që është caktuar paraprakisht. Shkarkimi nuk është i domosdoshëm (përjashtim: shkarkimi i menjëhershëm).

## Marrëdhënia e punës për kohë të pacaktuar

Marrëdhënia e punës për kohë të pacaktuar mund të përfundoj në mënyrë të njëanshme përmes shkarkimit. Në këtë rast duhet të respektohet periudha e paraparë e shkarkimit (përjashtim: shkarkimi i menjëhershëm).

## Periudha e shkarkimit në marrëdhëniet e punës sipas së drejtës private

Në rast se nuk është paraparë as me kontratë të përgithshme të punës e as me kontratë të veqantë të punës, atëherë vlejnë periudhat ligjore të shkarkimit sipas së drejtës së detyrimeve (OR):

| | |
|---|---|
| Në vitin e 1-rë të punës: | 1 muaj<br>në fund të muajit |
| Nga viti i 2-të deri në të 9-të të punës: | 2 muaj<br>në fund të muajit |
| Pas vitit të 10-të të punës: | 3 muaj<br>në fund të muajit |

## Periudha provuese në marrëdhëniet e punës sipas së drejtës private

Pa ndonjë rregullore të caktuar (marrëveshje me shkrim ose kontratës së përgithshme të punës) vlen muaji i parë si periudhë provuese. Me shkrim mundet periudha provuese të caktohet maksimalisht për tre muaj. Në rast se punëmarrësja apo punëmarrësi gjatë periudhës provuese është i penguar për shkak të sëmundjes, aksidentit ose përmbushje e një detyre ligjore jo vullnetare, atëherë zgjatet periudha provuese aq sa ka zgjat pengimi.

Në rast se nuk është paraparë as me kontratë të përgithshme të punës e as me kontratë të veqantë të punës atëherë vlen periudha ligjore e shkarkimit prej 7 ditëve në fund të një dite sipas dëshires.

## Efektshmëria e shkarkimit

Shkarkimi bëhet i efektshëm me dërgimin tek marrësi. Në rast se marrësit nuk i vije një shkarkim i dërguar me rekomandim, por i vije fletëthirrja për ta pranuar atë, atëherë shkarkimi cilësohet si i dërguar, me kusht që ai mund të mirret (respektivisht më se voni7 ditë pas marrjës së fletëthirrjes për pranim).

Periudha e shkarkimit fillon se zbatuari jo më herët së pas ditës kur është dërguar.

# Këshilla

## Këshilla për kërkim të punës

### Veprimi sistematik

Të aplikosh në mënyrë intensive është një «punë – me orar të plotë». Një organizim i mirë gjatë kërkimit të punës mund të sjellë një sukses më të shpejtë. Në vazhdim do të gjeni disa këshilla organizative për kërkimin tuaj të punës:

– Krijoni një dosje atraktive dhe të plotë të aplikimit.
– Siguroni qartësi për mundësitë tuaja.
– Krijoni një strategji të përshtatshme të aplikimit.
– Krijoni lista kontrolluese dhe një përmbledhje të të gjitha aplikacioneve të dërguara dhe ende të hapura.
– Shënoni çështjet e pazgjidhura.

### Vendet e lira

Shfrytëzoni paralelisht kanale të ndryshme për të gjetur vende të lira:

– Rrjeti i juaj personal i njohjeve
– Bursat e punësimit në internet
– Shpalljet e punësimit në mediat e shkruara (gazetat ditore, magazinat profesionale, etj.)
– Platformat e mediave sociale (Facebook, Xing etj.)
– Ndërmjetësues privat të punësimit

### Të aplikosh në mënyrë kompetente

Bisedoni me këshilltaren tuaj personale ose me këshilltarin tuaj personal në lidhje me kërkimin tuaj personal të punësimit.

Për temën:
Broshurën e SECO-së «Si të aplikoj në mënyrë të drejtë?» mund ta gjeni në mënyrë elektronike në www.arbeit.swiss

### Zyra e aplikimit

Vizitoni zyrat tona të aplikimit në çfarëdo qendre të RAV-it – një lajmërim paraprak nuk është i domosdoshëm.

Për temën:
AWA St.Gall «Zyra e aplikimit»
www.awa.sg.ch > Arbeitslose und Stellensuchende
> RAV-Bewerbungsbüro/Bewerbungshilfe

# Të drejtat

## Të drejtat e juaja si kliente e RAV-it dhe klient i RAV-it

### E drejta për dëmshpërblim të papunësisë

Ju keni të drejtë për dëmshpërblim të papunësisë nëse
– jeni tërësisht ose pjesërisht i papunë,
– jetoni në Zvicër, keni mbaruar shkollimin e detyrueshëm dhe ende nuk e keni arritur moshën e pensionit të AHV-së,
– keni përmbushur periudhën e kontributit ose jeni të liruar nga përmbushja e saj,
– jeni të aftë për ndërmjetësim, keni pasur një ndërprerje të pranueshme të punës (së paku dy ditë pune pandërprerë) dhe keni përmbushur rregulloret e kontrollit (krahasoni në lidhje me këtë «Obligimet e juaja si kliente e RAV-it dhe klient i RAV-it» prej faqës 12).

Në rast të pyetjeve konkrete në lidhje me të drejtën tuaj personale për dëmshpërblim të papunësisë drejtohuni kases suaj të të papunëve.

### Lartësia e dëmshpërblimit të papunësisë

Keni të drejtë dëmshpërblimi për pesë meditje për çdo javë (nga e hëna deri të premten).

Dëmshpërblimi i juaj i papunësisë përbën 70% të rrogës suaj të siguruar. Në rast se keni fëmijë nën kujdesin tuaj (nën moshen 25 vjeqare), atëherë dëmshpërblimi i juaj i papunësisë përbën 80% të rrogës suaj të siguruar.

Në rast se keni fëmijë nën kujdesin tuaj, atëherë mund të kërkoni shtesa për fëmijë ose për shkollim.
Në rast të pyetjeve për dëmshpërblimin tuaj personal të papunësisë drejtoheni kases suaj të papunëve.

Nëse rroga juaj e siguruar ësht ndërmjet CHF 3797 deri në CHF 4340 athëre e keni nje meditje minimale nga CHF 140.

Për temën:
Broshurën e SECO-së «Një udhëzues për të siguruarit» mund ta gjeni në mënyrë elektronike në www.arbeit.swiss

**Shpjegim i shkurt**

**«Periudha e kontributit»**
Gjatë dy viteve të fundit para lajmërimit të papunësisë ju duhet të keni paguar kontributet për sigurimin e të papunëve për së paku 12 muaj.

**«i aftë për ndërmjetësim»**
Jeni i gatshëm, në gjendje dhe i autorizuar të pranoni një punë të arsyeshme dhe të merrni pjesë në masat e caktuara.

**«Rregulloret e kontrollit»**
Ju duhet të merrni pjesë personalisht në takimet këshilluese dhe të dëshmoni për përpjekjet tuaja për punësim

**«Rroga e siguruar»**
Mesatarja e rrogës për të cilën janë paguar kontributet e AHV-së për 6 ose, në rast së më gjatë, 12 muajve para papunësisë, maksimalisht 148.200 franga (pagë vjetore)

## Zgjatja e pagesës së dëmshpërblimit të papunësisë

Varësisht nga rrethanat personale (si p.sh. periudha e kontributit, mosha, obligimi i kujdestarisë) mund të merrni dëmshpërblim të papunësisë prej katër muajve deri në dy vite.

| Periudha e kontributit (në muaj) | Mosha/ obligimi i kujdestarisë | Kushtet | Meditjet |
|---|---|---|---|
| 12 deri 24 | gjerë në 25 pa obligim të i kujdestarisë | | 200 |
| 12 deri < 18 | prej 25 | | 260 *** |
| 12 deri < 18 | me obligim të kujdestarisë | | 260 *** |
| 18 deri 24 | prej 25 | | 400 *** |
| 18 deri 24 | me obligim të kujdestarisë | | 400 *** |
| 22 deri 24 | prej 55 | | 520 *** |
| 22 deri 24 | prej 25 | Marrja e një pensioni invalidor, që përbën një shkallë të invaliditetit prej më së paku 40% | 520 *** |
| 22 deri 24 | me obligim të kujdestarisë | Marrja e një pensioni invalidor, që përbën një shkallë të invaliditetit prej më së paku 40% | 520 *** |
| I liruar nga kontrolli | | | 90 |

*** Këto kategori të të siguruarve kanë të drejtë për 120 meditje shtesë nëqoftëse 4 vite para arritjes së moshës së pensionit të AHV-së kanë mbetur të papunë.

Në kuptimin e një «Vetëparticipimit» pagesa e parë bëhet pas kalimit të disa ditë pritjeje. Numri i këtyre ditëve të pritjes varet sidomos nga të hyrat dhe obligimi i kujdestarisë.

## Takimet këshilluese

Këshilltarja personale ose këshilltari personal në RAV mban takime këshilluese me ju për çdo dy muaj, ose sipas nevojës edhe më shpesh. Në rast së me arsyetim nuk mund të paraqiteni në termine, atëherë duhet ta njoftoni këshilltaren tuaj personale ose këshilltarin tuaj personal 24 orë më herët.

## Masat e tregut të punës

Masat e tregut të punës (AMM) do duhej të rrisnin atraktivitetin tuaj në tregun e punës dhe të përmirësonin gjasat e juaja për punësim.

AMM mund të jenë:

– Kurse të ndryshme/programe inkuadrimi

– Praktika të punës dhe shkollimit

– Grante për trajnim

– Përkrahje e vetëpunësimit
– Oferta këshilluese dhe trajnuese

Ju bashkërisht me këshilltaren tuaj personale ose këshilltarin tuaj personal vendosni për përdorimin e njëres nga AMM-të. AMM-të munden poashtu të caktohen.

Ju mund të parashtroni kërkesa për financimin e kurseve dhe shkollimeve të mëtutjeshme çdoherë tek këshilltarja e juaj personale ose këshilltari i juaj personal.

Për temën:
Broshurën e SECO-së «Masat e tregut të punës» mund ta gjeni në mënyrë elektronike në www.arbeit.swiss

## Pushimet gjatë papunësisë

Ju keni të drejtë për pesë ditë pushim (ditë të liruar nga kontrolli) pas çdo 60 ditëve të kontrolluar të papunësisë. Gjatë pushimit nuk jeni i detyruar të paraqiteni në takime dhe të përpiqeni për punë.

Por, mos harroni ta dërgoni formularin «Të dhënat për personin e siguruar» me kohë tek kasa e juaj e të papunëve, në mënyrë që mos të iu vonohet pagesa.

Ju mund të ruani ditët e pushimit. Pushimi mirret komplet me javë. Nuk mund të shfrytëzoni ditët e pushimit para kohës. Ditët e pashfrytëzuara të pushimit humbin pas skadimit të kornizës kohore. Lajmëroni shfrytëzimin e ditëve të pushimit më së largu dy javë më herët tek këshilltarja e juaj personale e RAV-it ose tek këshilltari i juaj personal i RAV-it.

Shfrytëzimi të ditëve të pushimit gjatë një mase të tregut të punës është vëq në raste të veqanta e lejuar.

## Mbrojtja e të dhënave

RAV-i dhe kasa e të papunëve iu përmbahen rregulloreve për mbrojtjen e të dhënave. Ju keni çdoherë të drejtën të shihni të dhënat tuaja që janë të ruajtura dhe përpunuara nga RAV-i dhe kasa e të papunëve.

## Pagesat gjatë kërkimit të punës jashtë shtetit

Nëqoftëse dëshironi të kërkoni punë në shtetet anëtare të BE-së ose EFTA-së, atëherë mundeni të drejtën tuaj në Zvicër për dëmshpërblim të të papunëve ta eksportoni (eksport i shërbimeve) për maksimalisht tre muaj dhe nën kushte të caktuara. Informohuni në zyrat tuaj të RAV-it për mundësitë.

Në rast së kërkimi i juaj i punës mbetet pa sukses, atëherë duhet të ktheheni para skadimit të afatit në Zvicër dhe të lajmërohuni në RAV.

**Si kujtim**

**«Adresa e Scan-Center»**
Amt für Wirtschaft und Arbeit
Scan-Center
Geltenwilenstrasse 18 / PF 2
9001 St.Gallen

# Obligimet

## Obligimet e juaja si kliente e RAV-it dhe klient i RAV-it

### Dispozicioni

Nëqoftëse pranoni shërbime nga sigurimi i të papunëve, atëherë duhet të jeni në dispozicion brenda 24 orëve përmes postës, adresës elektronike ose telefonit.

### Obligimi i informimit dhe lajmërimit

Në kuadër të obligimit të informimit dhe lajmërimit, ju do ti tregoni RAV-it dhe kasës suaj të të papunëve të gjitha informatat, të cilat kërkohen për të sqaruar të drejtën tuaj për dëmshpërblim të të papunëve.
Ju duhet ti tregoni me kohë RAV-it dhe kasës të të papunëve poashtu të gjitha ndryshimet në lidhje me të drejtën tuaj për dëmshpërblim të të papunëve, sidomos kur:

– të filloni një punë ose kur krijoni të hyra të pjesshme,
– të bëni ditë provuese /njoftuese në një firmë,
– bëni pushim ose kur mungoni për arsye tjera (njoftimi të bëhet 14 ditë më herët),
– nuk jeni i aftë për punë si pasojë e sëmundjes ose aksidentit (njoftimi duhet bërë brenda një jave),
– nuk mund të merrni pjesë me një takim (njoftim para takimit),
– duhet kryer shërbim ushtarak, mbrojtje civile ose shërbim civil,
– ndryshon adresa e juaj, numri i telefonit ose të dhënat tjera kontaktuese,
– keni aplikuar ose pranoni pension ose meditje nga një sigurim tjetër,
– të filloni një vetëpunësim.

### Kërkimi i punës dhe obligimi, të pranosh një punë të arsyeshme

Si kliente ose klient do të ndërmerrni të gjitha veprimet e mundshme për të shmang ose për të shkurtuar papunësinë.
Në kuadër të obligimit të zvogëlimit të dëmit është në përgjegjësinë tuaj të kërkoni punë, nëse është nevoja edhe jashtë profesionit tuaj të deritanishëm ose orarit të dëshiruar të punës. Detyrimi i juaj për të kërkuar një vend pune vlen në të vertetë para hyrjes në papunësi, si p.sh. gjatë periudhës së shkarkimit ose gjatë marrëdhënies së punës për kohë të caktuar. Parimisht duhet të pranoni menjëherë çdo punë që mund ta kryeni.

### Dëshmia e përpjekjeve personale për punësim

Tek zyra e juaj përgjegjëse e RAV-it duhet të dëshmoni për çdo muaj (= periudha e kontrollit) me shkrim, më se largu gjerë në ditën e 5-të të muajit në vijim, që keni kërkuar punë. Formularët, të cilët dërgohen pas ditës së 5-të të muajit në vijim, nuk mund të merren parasysh pa ndonjë arsyetim të falshëm. Formulari i dëshmisë duhet të jetë i plotësuar me shkrim të lexueshëm (sistem të shkrimit ose dorëshkrim) dhe i plotë.

Për temën:
Formularin «Dëshmia e përpjekjeve personale për punësim» mund ta gjeni në mënyrë elektronike në www.arbeit.swiss

## Formulari «Dëshmia e përpjekjeve personale për punësim»

Ju do të merrni në mënyrë direkte nga SECO për çdo muaj formularin «Dëshmia e përpjekjeve personale për punësim». Ky formular vlen vetëm për muajin i cili është i shënuar lartë në pjesën e djathtë.

Dorëzoni formularin në origjinal dhe të nënshkruar më së largu në **ditën e 5-të të muajit në vijim** ose në **ditën e parë të punës pas ditës së 5-të** në zyrën tuaj të RAV-it ose ia dërgoni më se largu direkt RAV-it (vula e postës) në Scan-Center. Kjo vlen poashtu edhe në rast të mungesës së planifikuar gjatë ndërrimit të muajve. Nëse nuk i keni pranuar dokumentet gjerë në fund të muajit, atëherë lajmërohuni menjëherë tek zyra përgjegjëse e RAV-it.

0716007 – 001 – 04 - 2012

716.007 d 04.2012

**Arbeitslosenversicherung**

Eingangsdatum / Datum des Poststempels

**Nachweis der persönlichen Arbeitsbemühungen**

| Name und Vorname | AHV-Nr. | Monat und Jahr |
|---|---|---|

| Datum der Bewerbung<br>Tag Monat | Firma, Adresse<br>Kontaktperson, Telefon-Nr. | Stellenbezeichnung | Zuweisung RAV | Pensum: Vollzeit | Pensum: Teilzeit (%) | Bewerbung: Schriftlich / elektronisch | Bewerbung: Persönlich | Bewerbung: Telefonisch | Ergebnis der Bewerbung: noch offen | Vorstellungs-gespräch | Anstellung | Absage | Absagegrund |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | |

Datum: ______________________ Unterschrift der versicherten Person:

Beilagen: ______________________ ______________________

**Hinweis**

Die versicherte Person muss alles Zumutbare unternehmen, um Arbeitslosigkeit zu vermeiden oder zu verkürzen. Insbesondere ist es ihre Sache, Arbeit zu suchen, wenn nötig auch ausserhalb ihres bisherigen Berufes (Art. 17 AVIG).

Die Pflicht, sich persönlich um Arbeit zu bemühen, gilt bereits vor Eintritt der Arbeitslosigkeit (z.B. während der Kündigungsfrist oder dem befristeten Arbeitsverhältnis).

Die versicherte Person muss der zuständigen Amtsstelle für jede Kontrollperiode (Kalendermonat) bis spätestens am 5. Tag des Folgemonats schriftliche Angaben über ihre Bemühungen um Arbeit einreichen (Art. 26 AVIV). Dazu dient dieses Formular. Schriftliche Unterlagen wie Kopien von Bewerbungsschreiben oder Absagebriefen sind beizulegen.

Nach dem 5. Tag des Folgemonats eingereichte Arbeitsbemühungen können nicht mehr berücksichtigt werden, ausser es liegt ein entschuldbarer Grund vor.

Versicherte Personen, die sich nicht genügend um zumutbare Arbeit bemühen oder eine solche ablehnen, werden je nach dem Verschulden bis zu einer Dauer von höchstens 60 Tagen in der Anspruchsberechtigung eingestellt (Art. 30 AVIG).

Mit unwahren oder unvollständigen Angaben macht sich die versicherte Person strafbar (Art. 105 ff. AVIG).

| Datum der Bewerbung<br>Tag Monat<br>(Beispiel)<br>0 1 1 2 | Firma, Adresse<br>Kontaktperson, Telefon-Nr. | Stellenbezeichnung | Zuweisung RAV | Pensum: Vollzeit | Pensum: Teilzeit (%) | Bewerbung: Schriftlich / elektronisch | Bewerbung: Persönlich | Bewerbung: Telefonisch | Ergebnis der Bewerbung: noch offen | Vorstellungs-gespräch | Anstellung | Absage | Absagegrund |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 0 6 0 5 | Muster AG, Losstrasse 5,<br>9000 St.Gallen / Herr Müller | Hilfsarbeiter Produktion | X | X | | X | | | | X | | | Lohnangebot zu gering |
| 1 2 0 5 | ABB Technik, Tellstrasse 12,<br>8001 Zürich Tel. 055 11 12 13 | Betriebsarbeiter | | | X | | X | | X | | | | |
| 2 0 0 5 | ZAZ GmbH, Hauptstrasse 13,<br>9320 Arbon / Frau Meierhans | Lagermitarbeiter | | X | | X | | | | X | X | | Anstellung per<br>01.06.2015 - Vertrag |
| 2 0 0 5 | Schluss AG, Schulstrasse 23, 9320<br>Arbon / Herr Rutz / 083 777 12 12 | Mithilfe Hauswartung | X | | X | X | | | | X | | X | Stelle schon besetzt |

# Obligimi i zvogëlimit të dëmit

## Obligimi i zvogëlimit të dëmit

Për të përmbushur obligimin për zvogëlimin e dëmit në masë të kënaqshme, ju duhet:

– që gjatë periudhës se shkarkimit (d.m.th. pas pranimit të shkarkimit me shkrim ose me gojë), përkatësisht gjatë tre muajve të fundit të një punësimi me kohë të caktuar, përkatësisht kur papunësia është e parashikuar (punësim sezonal) të përpiqeni tre muaj më herët për një vend të ri të punës,
– në rast të aftësisë së pjesshme për punë (sëmundje ose aksident) të përpiqeni për punë,
– deri në takimin të parë me këshilltarin ose këshilltaren tuaj personale duhet të perpiqëni mjaftësisht për një vend të ri të punës. Rregullisht kërkohen 8 perpjekje për vendë të punes në muaj të cilët duhet ti deklaroni. Në takimin tuaj të parë me këshilltarin ose këshilltaren tuaj personale do të bëni marrëveshjen per formen tuaj në të cillen duhet ti bëjni përpjekjet tuaja për vend të ri të punës (shuma, forma e përpjekjeve të kërkimit, etj.),
– dhënë informacione të plota dhe që mund të verifikohen; sidomos tek përpjekjet personale dhe /ose telefonike duhet dhënë mes tjerash emri i personit kontaktues, adresa e firmës dhe numri i telefonit,
– gjatë zgjatjes së masave të tregut të punës (si p.sh. kurs, program punësimi, praktikë) të kryeni përpjekjet për punësim në kornizën e zakonshme,
– bërë poashtu edhe gjatë pushimeve pa pagesë përpjekje për punë,
– bërë personalisht përpjekjet për punësim. Një kërkesë /dhënie e adresës tek një zyreje për ndërmjetësim të punësimit pranohet vetëm njëherë si një përpjekje personale për punësim,
– që në aplikimet ende pa rezultat për një vend të punës të vazhdoni përpjekjet për punësim. Vetëm pas prezantimit të një kontrate me shkrim të punës (me fillim të punës brenda 30 ditëve) jeni të liruar nga kërkimi,

## Arsyet për pezullimin e mundshëm të shërbimeve financiare

Mospërmbushja e obligimeve dhe këshillave mund të këtë si pasojë ditë pezullimi.

– papunësi e vetëshkaktuar,
– përpjekjet e punësimit të munguar, të pakta, për nga cilësia të pamjaftueshme dhe të dërguar me vonesë,
– shkelja e obligimit kontrollues (sidomos mungesat e paarsyeshme në takimet këshilluese,
– mospërmbushja e marrëveshjeve dhe këshillave,
– mospjesëmarrja në masat e caktuar të tregut të punës,
– refuzimi i punës se arsyeshme,
– mospërmbushja e obligimit të informimit dhe lajmërimit,
– të dhënat e pavërteta dhe të paplota.

**Shpjegim i shkurt**

**«Obligimi i zvogëlimit të dëmit»**
Personi i siguruar duhet të ndërmerr të gjitha veprimet e mundshme për të shmang ose shkurtuar papunësinë.

**«Ditë pezullimi»**
Ditë pezullimi janë ditë, në të cilat shlyhen meditjet, d.m.th. nuk ka dëmshpërblim të papunësisë.

Ditë pezullimi duhet shqiptuar kur personi punëkërkues nuk iu përmbahet obligimeve.

## Formulari «Të dhënat e personit të siguruar»

Ju do të merrni në mënyrë direkte nga SECO për çdo muaj formularin «Të dhënat e personit të siguruar». Ky formular vlen vetëm për muajin i cili është i shënuar në të.
Formularin mund ta dërgoni menjëherë pas pranimit direkt në kasen tuaj të të papunëve në Scan-Center.



Arbeitslosenversicherung

**Angaben der versicherten Person für den Monat** ____________

Zu Handen Ihrer

P.P. RAV, Unterstrasse 4, CH-9001

AHV-Nr.
Geburtsdatum
Telefon-Nr.
Personennummer

➩ Bitte beantworten Sie die Fragen

Falls das Formular nicht vollständig … vornehmen.

Der Anspruch auf Versicherungsleis… Kontrollperaiode, auf die er sich bez…

Unwahre oder unvollständige Angab… Unrecht bezogene Leistungen müss…

Ort und Datum:

0716106 – 001 – 01 – 2013

Monat: ____________

**1. Haben Sie bei einem oder mehreren Arbeitgebern gearbeitet?** Ja ○ Nein ○
Falls ja, vom ______ bis ______ Arbeitgeber: ____________
vom ______ bis ______ Arbeitgeber: ____________
(bitte Bescheinigung(en) über Zwischenverdienst und Lohnabrechnung(e) beilegen)

**2. Haben Sie eine selbständige Erwerbstätigkeit ausgeübt?** Ja ○ Nein ○
Falls ja, vom ______ bis ______
(bitte Belege/Abrechnungen beilegen)

**3. Haben Sie an einer arbeitsmarktlichen Massnahme teilgenommen? (Bsp. Kurs, Programm zur vorübergehenden Beschäftigung, Praktikum)** Ja ○ Nein ○

**4. Waren Sie arbeitsunfähig?** Ja ○ Nein ○
Meldung am ____________ an ____________
Wegen Krankheit: vom ______ bis ______
Wegen Unfall: vom ______ bis ______
(bitte Arztzeugnisse beilegen)
Aus anderen Gründen? Welche? ____________ vom ______ bis ______
**Haben Sie eine Taggeldversicherung für den Krankheitsfall?** Ja ○ Nein ○

**5. Haben Sie Militär- oder Zivildienst, resp. Zivilschutz geleistet?** Ja ○ Nein ○
Falls ja, vom ______ bis ______

**6. Waren Sie in den Ferien?** Ja ○ Nein ○
Falls ja, vom ______ bis ______
**Waren Sie aus anderen Gründen abwesend?** Ja ○ Nein ○
Falls ja, warum? ____________ vom ______ bis ______

**7a. Hat sich Ihre Unterhaltspflicht oder diejenige Ihres Ehegatten/Ihrer Ehegattin oder Ihres/Ihrer eingetragenen Partners/Partnerin gegenüber Kindern unter 18 Jahren oder Kindern in Ausbildung verändert?** Ja ○ Nein ○
(Falls ja, bitte Geburtsschein, Lehrvertrag, Bestätigung der Ausbildungsstätte und/oder Abschlussdiplom beilegen)

**7b. Hat eine andere Person (z.B. anderer Elternteil) Anspruch auf Kinder- und/oder Ausbildungszulagen?** Ja ○ Nein ○
Dies ist immer der Fall, wenn diese Person ein Mindesterwerbseinkommen von CHF 585.-- pro Monat erzielt (Stand: 1. Januar 2013)

**8. Haben Sie Leistungen einer anderen in- oder ausländischen Sozialversicherung verlangt oder erhalten (z.B. IV, SUVA, berufliche Vorsorge, AHV-Rentenvorbezug)?** Ja ○ Nein ○
(Falls ja, bitte Kopie der Verfügung und der Abrechnung beilegen)

**9. Suchen Sie im gleichen Umfang (%) Arbeit wie im Vormonat?** Ja ○ Nein ○
Falls nein, in welchem Umfang suchen Sie insgesamt Arbeit? ______ % ab wann? ______

**10. Sind Sie weiterhin arbeitslos?** Ja ○ Nein ○
Arbeitsaufnahme am ____________

Bemerkungen: ____________

Bitte frei lassen

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 | 31 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

### Me rëndësi

Formularë të mbushur jo plotësisht dhe të panënshkruar nuk mund të përpunohen nga kasa e të papunëve. Kjo mund të sjellë vonesa në pagesën e meditjeve.

### Si kujtim

**«Adresa e Scan-Center»**
Amt für Wirtschaft und Arbeit
Scan-Center
Geltenwilenstrasse 18 / PF 2
9001 St.Gallen

# Sigurimi

## Sigurimet e juaja gjatë papunësisë

### AHV/IV/EO

Nga meditjet tërhiqen automatikisht kontributet e AHV/IV/EO.
Për shkak të kësaj rregulloreje nuk duhet të keni frikë nga boshllëku i kontributeve.

### Sigurimi pensional

Sigurimi pensional gjatë papunësisë i mbulon vetëm rreziqet e vdekjes dhe të invaliditetit, por jo kursimet pensionale. Për këtë arsye sigurimi i obligueshëm pensional për persona të papunë është vetëm një sigurim nga rreziqet – njëjtë sikurse sigurimi nga aksidenti dhe i të papunëve – dhe jo sigurim i pleqërisë.

Për këtë arsye kontributet e deritanishme të kursyera të pensionit, këto janë mjetet e grumbulluara nga fondi pensional tek punëdhënësi i fundit, nuk mund të transferohen në fondin e mbledhjes së sigurimeve pensionale të BVG-së.

Për temën:
Broshurën e SECO-së «Sigurimi pensional për persona të papunë» mund ta gjeni në mënyrë elektronike në www.arbeit.swiss

### Aksidenti

Gjatë kohës sa merrni dëmshpërblim të të papunëve, ju jeni të siguruar tek SUVA kundër aksideniteve. Kontributi për aksidente jashtë punës (NBU) tërhiqet nga meditjet.
Njoftoni menjëherë RAV-in, në rast që keni pasur një aksident.
Kontaktoni kasën tuaj për lajmrimin të aksidentit, e cila e deklaron aksidentin tëk SUVA dhe dot ju dërgoj formularin e aksidentit.

Për temën:
Broshurën e SUVA-së «Sigurimi nga aksidentet gjatë papunësisë, informacionet nga A deri në Z.» mund ta gjeni në mënyrë elektronike në www.suva.ch/de-ch/ versicherung/versicherung/unfallversicherung-fuer-arbeitslose

## Sëmundja

Në rast sëmundjeje jeni të siguruar përmes sigurimit të të papunëve si vijon:

– maksimalisht 30 ditë kalendarike (20–22 meditje) në rast të sëmundjes së pandërprerë,
– maksimalisht 44 meditje gjatë një kornizë kohore.

Njoftoni RAV-in menjëherë në rast të sëmundjes.
Më se largu pas ditës së 4-të ju kërkohet vërtetimi i mjekut.
Origjinalin dërgoni tek Scan-Center.

Në krahasim me sigurimin e obligueshëm për kujdesje shëndetësore (KVG) nuk është i obligueshem të bëhet sigurimi i meditjeve në rast të sëmundjes. Shumica e punëmarrësve janë të siguruar nga punëdhënësi i tyre në rast të mungesës së të ardhurave për shkak të sëmundjes. Në ju këshillojmë të verifikoni, se a ia vlenë për ju që të keni këtë mbrojtje të sigurimit edhe gjatë papunësisë.

Për temën:
Broshurën e SECO-së «Udhëzues për të siguruarit» mund ta gjeni në mënyrë elektronike në www.arbeit.swiss

## Lehonia

Nëse ju si kliente gjatë marrjes se dëmshpërblimit të të papunëve lindni një fëmijë, atëherë keni të drejtë për pushim të paguar të lehonisë për 14 javë pas lindjes.
Kërkesen për dëmshpërblim të lehonisë duhet ta parashtroni tek fondi përgjegjës i kompenzimeve të AHV-së.

Për temën:
Formularin «Regjistrimi për një dëmshpërblim të lehonisë» mund ta gjeni në mënyrë elektronike në www.ahv-iv.info > Dienstleistungen > Merkblätter & Formulare > Formulare > Leistungen der EO-MSE

**Si kujtim**

**«Adresa e Scan-Center»**
Amt für Wirtschaft und Arbeit
Scan-Center
Geltenwilenstrasse 18 / PF 2
9001 St.Gallen

# Informacion

## Broshurat

- Papunësia:
  Një udhëzues për të siguruarit
- Masat e tregut të punës:
  Një hap i parë për riintegrim
- Pagesat gjatë kërkimit të punës jashtë shtetit

- Sigurimi pensional për persona të papunë
- Sigurimi nga aksidenti për të papunët

- Si të aplikoj në mënyrë të drejtë?
- Letra shoqëruese
- Dosja e aplikimit
- Aplikimi elektronik
- Aplikimi telefonik
- Takimi prezantues

- Fillimi në jetën profesionale

## Formularët

- Kërkesa për dëmshpërblim të papunësisë
- Vërtetimi i punëdhënësit për sigurimin e të papunëve
- Dëshmia e përpjekjeve personale për punësim
- Vërtetimi për të hyrat e pjesshme
- Detyrimi i kujdesit ndaj fëmijëve

**Shpjegim i shkurt**

Këto broshura dhe broshura siashtu dhe formulare të tjera mund ti merrni në të gjitha zyret e RAV-it në kantonin e St.Galles, ose si PDF dokument në **www.arbeit.swiss**

**Impressum**

**Botuesi**
Amt für Wirtschaft und Arbeit
Unterstrasse 22
9001 St.Gallen

**10.2018**
Kjo broshurë është poashtu
edhe në gjuhë të tjera e
disponueshme në faqen
**www.awa.sg.ch**

**Amt für Wirtschaft und Arbeit**
**Unterstrasse 22**
**9001 St.Gallen**

**www.awa.sg.ch**